

PËRMBLEDHJE

MBI DRAFTIN E DOKUMENTIT POLITIK PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME 2026-2030

Qershor 2026

Në datën 4 Qershor 2026 në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike¹ u publikua për konsultim publik drafti “*Dokumentit Politik për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2026-2030*” (“*Dokumenti*”) i shoqëruar me Relacionin dhe Dokumentin Shoqërues.

Politikat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri të cilat përbëjnë bazën e ekonomisë shqiptare, pasi përfaqësojnë mbi 99% të ndërmarrjeve aktive, gjenerojnë më shumë se 80% të punësimit dhe mbajnë peshën kryesore të aktivitetit ekonomik në vend. Nisur nga kjo, si edhe nga fakti që Këshilli i Investimeve (KI) në vazhdimësi ka trajtuar problematika për këtë kategori biznesesh, përfshirë edhe diskutime dhe komente që në vitin 2021 mbi projektligjin “*Për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, Të Vogla Dhe Të Mesme*”² dhe “*Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve dhe Planit të Veprimit 2021-2027*”³, u prioritetizua një mbledhje e dedikuar e KI për konsultimin sa më të gjerë të Dokumentit.

Për qëllime të eficiencës së konsultimit publik dhe në vijim të ftesës elektronike për paraqitjen e komenteve dërguar anëtarëve dhe partnerëve të KI që në datën 8 Qershor 2026, nga Sekretariati janë përgatitur në mënyrë sintetike disa nga elementet kryesore të Dokumentit të cilat mund të jenë objekt pyetjesh, komentesh, sugjerimesh apo debati në mbledhjen e të KI të datës 30 Qershor 2026.

- (1) *Korniza e integruar e politikave*: Dokumenti është konceptuar si një kornizë e integruar politikash që synon rritjen e produktivitetit, konkurrueshmërisë dhe ndërkombëtarizimit të NVM-ve shqiptare, në përputhje me Strategjinë e BE-së për NVM-të dhe objektivat e integrimit evropian. Dokumenti është ndërtuar sipas logjikës së ndërhyrjes që lidh sfidat e identifikuara me qëllimet strategjike, objektivat specifike, masat dhe treguesit e performancës. Në këtë mënyrë sigurohet një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet analizës së situatës, ndërhyrjeve të propozuara dhe rezultateve të pritshme deri në vitin 2030.

¹ <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/988>

² https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2021/07/EN_Suggestions-by-the-Secretariat-on-draft-law-on-MSMEs.pdf

³ https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2021/07/EN_AIC-Secretariat_Draft-suggestions-on-draft-BIDS-2021-2027-1.pdf

- (2) *Strukturimi i Dokumentit*: Dokumenti është strukturuar në pesë seksione kryesore, duke kaluar nga analiza e gjendjes aktuale drejt përcaktimit të objektivave strategjike, planit të veprimit dhe mekanizmave të monitorimit e vlerësimit.

Seksioni I - paraqet bazën konceptuale, strategjike dhe institucionale të dokumentit. Në këtë pjesë theksohet roli i NVM-ve në zhvillimin ekonomik të vendit, duke qenë se ato përbëjnë 99.9% të ndërmarrjeve aktive, sigurojnë mbi 82% të punësimit dhe kontribuojnë me rreth 78% të vlerës së shtuar në ekonomi. Dokumenti përcakton si synim kryesor rritjen e produktivitetit, forcimin e konkurrueshmërisë dhe zgjerimin e integritetit të NVM-ve në zinxhirët evropianë dhe globalë të vlerës.

Seksioni II - ofron një analizë të gjendjes aktuale së sektorit të NVM-ve. Në këtë kuadër evidentohet pjesëmarrja ende e kufizuar e ndërmarrjeve në eksporte dhe në zinxhirët ndërkombëtarë të vlerës, si dhe përqendrimi i aktivitetit ekonomik në disa qendra urbane, veçanërisht në Tiranë. Analiza identifikon pesë problematika kryesore strukturore: (i) mospërputhjen midis aftësive të fuqisë punëtore dhe kërkesave të tregut; (ii) nivelin e ulët të përdorimit të teknologjisë dhe inovacionit, (iii) aksesin e kufizuar në financim, (iv) pengesat rregullatore dhe administrative, si dhe (v) integrimin e pamjaftueshëm në zinxhirët rajonalë dhe evropianë të vlerës.

Seksioni III - organizohet rreth tre qëllimeve strategjike. *Qëllimi i parë* synon zhvillimin e kapaciteteve të NVM-ve përmes forcimit të aftësive sipërmarrëse, promovimit të inovacionit, digjitalizimit, standardizimit dhe tranzicionit të gjelbër. *Qëllimi i dytë* fokusohet në përmirësimin e mjedisit operacional të biznesit, duke adresuar cilësinë e kuadrit rregullator, efikasitetin e shërbimeve publike dhe mbështetjen për ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve. *Qëllimi i tretë* synon zhvillimin e ekosistemit të kapitalit dhe menaxhimit të riskut, duke përmirësuar aksesin në financa, nivelin e edukimit financiar dhe instrumentet e ristrukturimit të biznesit.

Seksioni IV - përbën komponentin operacional të dokumentit, duke përkthyer objektivat strategjike në masa dhe aktivitete konkrete zbatimi. Në këtë pjesë paraqitet matrica e planit të veprimit, ku specifikohen ndërhyrjet e planifikuara, dhe treguesit për monitorimin e progresit me pikënisje vitin 2025 dhe pikëmbërritje vitin 2030.

Seksioni V - trajton sistemin e monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të performancës së dokumentit gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Mekanizmat e monitorimit janë të organizuar në tre nivele: raportimi periodik nga institucionet përgjegjëse, hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së NVM-ve dhe raportimi ndaj strukturave qeveritare dhe Bashkimit Evropian. Gjithashtu, dokumenti parashikon kryerjen e një vlerësimi të ndërmjetëm në vitin 2028 dhe një vlerësimi përfundimtar në vitin 2030, me qëllim matjen e progresit, identifikimin e sfidave

dhe përshtatjen e ndërhyrjeve sipas nevojës. Të dhënat e monitorimit përdoren gjithashtu për raportimet kombëtare dhe ato në kuadër të procesit të integritetit evropian, përfshirë Kapitullin 20, Agjendën e Reformave dhe Planin e Rritjes.

- (3) Dokumenti parashikon *3 Qëllime Strategjike, 11 Objektiva Specifike dhe 25 masa prioritare.*